



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

## Kodi i sjelljes

### për luftën kundër dhunës ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor

Ne, përfaqësuesit e partive politike të nënshkruar më poshtë, me këtë Kod shprehim vullnet të fuqishëm politik, me të cilin e kundërshtojmë dhunën ndaj grave në politikë, e veçanërisht dhunën ndaj grave që intensifikohet, forcohet dhe shumëfishohet gjatë fushatave zgjedhore.

#### PREAMBULA:

- I. Dhuna në politikë dhe në procesin zgjedhor paraqet përdorimin e qëllimshëm të forcës ose të frikësimit nga bartësit e funksioneve publike, bartësit e funksioneve partiake dhe ithtarët e tyre, për t'u arritur qëllimet politike. Dhuna politike i shkel të drejtat e njeriut, e pengon zhvillimin e demokracisë dhe e shemb besimin ndërmjet politikanëve dhe votuesve. Ajo ndikon në mënyrë serioze edhe te burrat edhe te gratë në politikë;
- II. Dhuna ndaj grave në politikë mund të ketë më shumë forma, siç janë: sulmet fizike, shqetësimi verbal dhe psikologjik (duke përfshirë sulmet ndaj jetës private të grave, pamjes fizike, moshës, veshjes, statusit martesor), kërcënimet, përgjimet, komentet seksuale dhe seksiste, keqpërdorimi onlajn dhe gjuha e urrejtjes dhe shqetësimi seksual;
- III. Dhuna ndaj grave të përfshira në politikë dhe në procesin zgjedhor nuk reflektohet vetëm në personalitetin e tyre, por edhe në familjet dhe fëmijët e tyre;
- IV. Dhuna politike ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor drejtohet kundër grave funksionare të zgjedhura dhe grave që janë të dukshme dhe ndikojnë në jetën publike dhe shoqërore dhe krijojnë opinionin publik;

Zbatuar nga:



International Foundation  
for Electoral Systems

Ky Kod është pjesë e mbështetjes teknike në suaza të Programit për mbështetjen e zgjedhjeve, projekt i bashkëpunimit Zvicëran në Maqedonë e Veriut i zbatuar nga Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore.

- V. Dhuna ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor paraqet pengesë serioze për pjesëmarrjen politike të grave, duke rrënuar dukshmërinë e tyre, pozicionin aktiv dhe qëndrueshmërinë e grave në funksionet politike, me çka forcohet bindja se politika është e rezervuar vetëm për meshkujt;
- VI. Për shkak të polarizimit të madh politik, shkalla e dhunës politike vjen gjithnjë e më tepër duke u rritur në mbarë botën. Fushatat zgjedhore janë mjedisi ku përhapet shqetësimi në bazë gjinore dhe gjuha e urrejtjes;
- VII. Gratë e dalluara aktive, gratë e reja si dhe gratë e grupeve të rrezikuara janë veçanërisht shënjestër e dhunës politike ndaj grave në politikë dhe në fushatën zgjedhore ;
- VIII. Mjedisi digjital dhe inteligjenca artificiale për shkak të anonimitetit që ofrojnë, kontribuojnë mjaft në krijimin dhe përhapjen e dhunës ndaj grave në politikë dhe në fushatën zgjedhore;
- IX. Heshtja e stimulon dhunën. Kundër dhunës ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor mund të bëhet luftë me dënim publik nga partitë politike dhe nga organizatat qytetare, me të folurit publik kundër saj dhe me praninë e shtuar të grave aktive, të fuqishme dhe të dukshme në politikë.
- X. Prania e dhunës ndaj grave nuk duhet t'i pengojë gratë politikane që të angazhohen për krijimin e një mjedisi debati të hapur dhe respektues për çështjet politike, zgjidhjet dhe politikat. Të angazhohen për një ligjërim konstruktiv që inkurajon perspektiva të larmishme dhe promovon shkëmbim idesh për të përmirësuar shoqërinë.

#### **Masat e rekomanduara:**

Ne, nënshkruesit e këtij kodi, nëpërmjet masave të rekomanduara më poshtë do të përpiqemi që:

1. të njihet se dhuna ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor është dukuri ekzistuese që ndikon në mënyrë negative në pjesëmarrjen politike të grave dhe të burrave dhe të përfaqësimit të votuesve;
2. të pranohet se dhuna ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor është dukuri që ndikon negativisht te të gjitha partitë dhe se nuk ka fitues kur ajo ushtrohet ndaj akëcilit, madje edhe ndaj kundërshtarëve politikë;
3. të ngrihen zërat edhe të burrave edhe të grave kundër dhunës ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor, me ekspozimin publik të provave për dhunë dhe me mbështetjen e plotë të personave të cilët do të inkurajohen ta ngrenë zërin publikisht kundër dhunës dhe të refuzohet qëndrimi se të folurit kundër dhunës në politikë është shenjë dobësie;
4. të ketë gatishmëri për sigurimin e mbrojtjes personale, të mbështetjes juridike dhe psikologjike për gratë e pranishme në jetën publike, të cilat kanë funksione politike

më të larta, e të cilat shpesh janë në mënyrë joproporcionale shënjestër e mesazheve të dhunshme;

5. të emërohet një person për kontaktim ose organ në partinë politike që do të shërbejë si një kanal i besueshëm për këshillëdhënie dhe mbështetje në rastet e dhunës ndaj grave në politikë dhe në procesin politik, me të drejtën për të siguruar këshilla juridike dhe për të përfshirë kryesinë partiake në rastet më të rënda. Këta persona për kontaktim ose këto organe do të bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjit në emër të grave ndaj të cilave është ushtruar dhunë;
6. t'u jepet hapësirë e mjaftueshme grave kandidate në zgjedhjet dhe në fushatat zgjedhore, me qëllim që të krijohen narrativët pozitivë për gratë në politikë. Të vihet në pah dukja e ekspertizës së grave në fusha të ndryshme, duke debatuar fuqishëm për qëndrimet, opinionet dhe propozimet e politikave. Të angazhohet mbështetja e komunikimeve partiake për të siguruar përfaqësimin e denjë dhe profesional të kandidateve femra në media, në bazë të meritave të tyre;
7. t'i kushtohet kujdes i veçantë trajtimit dhe parandalimit të dhunës ndaj grupeve të rrezikuara, siç janë: gratë e reja, gratë e bashkësive etnike më të vogla, gratë me aftësi të kufizuara dhe të tjera;
8. të hartohen udhëzime të brendshme për partitë politike se si të merren me dhunën ndaj grave në politikë dhe të zhvillohen trajnime për të gjithë kandidatët, të gjithë që punojnë në fushatë, vullnetarët dhe të gjithë ata që janë të përfshirë në zgjedhje lidhur me atë se si ta njohin dhunën ndaj grave në politikë dhe si ta parandalojnë dhe ta pengojnë atë me anë të veprimeve personale – bllokimin e përhapjes, denoncimin tek organet e zbatimit të ligjit, mbështetjen e të sulmuarve;
9. të pranohet se mjedisi onlajn dhe inteligjenca artificiale janë veçanërisht një truall pjellor për aktet e dhunës verbale dhe psikike dhe të keqpërdorimit ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor dhe me këtë të pengohet pjesëmarrja në përhapjen dhe në shpërndarjen e dhunës ndaj grave në politikë dhe procesin zgjedhor në mjedisin onlajn, madje edhe kur kjo gjë ndikon te gratë që janë kundërshtarë politikë;
10. t'u sigurohen kandidatëve të listave zgjedhore udhëzimet bazike se si të merren me ngacmimet kibernetike, duke përfshirë sigurinë e informacionit dhe si të përballen me çfarëdolloj ngacmimi ose frikësimi onlajn;
11. të zbulohet dhe të ndalohet përhapja e dezinformacioneve dhe përmbajtjeve të rreme „dipfejk“ të gjeneruara nga inteligjenca artificiale , që përfshijnë mesazhe dhe imazhe të dhunshme ndaj grave në politikë. Të mos merret pjesë në përhapjen e mesazheve dhe imazheve të sajara e të rreme që përmbajnë keqpërdorime të grave në politikë dhe menjëherë duhet të kontaktohen platformat që të parandalohet përhapja e tyre;
12. të pranohet se kryerësit e dhunës ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor mund të vijnë edhe nga vetë partia dhe rastet e këtilla duhet të trajtohen në mënyrë adekuate pa tentativa për t'i heshtur ato. Në statutet e partisë ose në kodin e sjelljes të përfshihet ndalesa e përfshirjes në sulme të dhunshme ndaj grave në politikë, duke paraparë sanksione për sjellje të pahijshme;

13. të krijohet një mjet i thjeshtë onlajn për vlerësimin e klimës organizative brendapartiake, që të vlerësohet se sa është ajo e favorshme dhe garanton mbrojtje dhe siguri për gratë anëtare, kandidatë dhe funksionare;
14. të vendoset komunikimi dhe të krijohet koncept i përbashkët me organet e zbatimit të ligjit, nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta për veprim në luftën kundër dhunës ndaj grave në politikë dhe në procesin zgjedhor;
15. të parandalohet, ndalohet, denoncohet dhe të flitet publikisht kundër dhunës së ushtruar ndaj grave që janë aktive dhe të pranishme në jetën publike – gazetaret, aktivistet e shoqërisë civile, nëpunëset administrative, nëpunëset e angazhuara në procesin zgjedhor dhe grupet e tjera;
16. të njihet roli i organizatave qytetare, të cilat e ndjekin dhunën ndaj grave në politikë, të bashkëpunohet me to dhe të shfrytëzohen mënyrat e tyre për trajtimin e dhunës së këtuilë. Të njoftohet Lobi i grave të Maqedonisë për rastet e dhunës ndaj grave në politikë dhe të bashkëpunohet me to në luftën kundër dhunës.